

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

**PUNIME NDIHMËSE GIPSI, PATINIME
DHE LYERJE**

Kodi: PK-B-9-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Ndërtim” , K-B-II-25, Niv II i KSHK-së:

1.NjN-02-II-0231-25 “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje”

Niveli II i KSHK¹, referuar nivelit të II të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

.....

1. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2. Korniza Europiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të II të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje” me kod 02-II-0231-25 do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhërit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME NDIHMËSE GIPSI, PATINIME DHE LYERJE

(PK-B-9-25)

I. Profili Profesional për punëtor ndihmës të punimeve gipsi, patinime dhe lyerje.

a) Karakteristikat për punimet ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje.

Punëtori ndihmës për punime gipsi, patinime dhe lyerje do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar në kompani ndërtimi, që kryejnë punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori ndihmës në gips, patinime dhe lyerje duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale në punime gipsi, patinime dhe lyerje. Suksesi i punëtorit ndihmës të punimeve gipsi, patinime dhe lyerje është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale

Profesioni i punëtorit ndihmës në punime gipsi, patinime dhe lyerje është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve ndihmëse në gips, patinime dhe lyerje.

Me përmbushjen e të gjithave njësive të të nxënës të standardit të kualifikimit “Ndërtim” Niveli i II i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e mëtejshme të KSHK-së. Ky kurs i përgatit kursantet me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale të përfshira në profesionin “Punëtor të ndërtimit të banesave” me kod 9313, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje.

Në përfundim të Kursit “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje kursantët do të jenë të aftë të:

- Ndihmojnë në organizimin e punës.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- Ndihmojnë në kryerjen e punimeve parapërgatitore;
- Ndihmojnë në kryerjen e përpunimit të materialeve të ndryshme;
- Ndihmojnë në përgatitjen e vendit të punës;
- Ndihmojnë në organizimin e punimeve për montimin e elementeve strukturore dhe pllakat e gipsit.
- Ndihmojnë në montimin e profileve metalike të strukturës.
- Ndihmojnë në montimin e paneleve të gipsit.
- Raportojnë për punën e kryer tek eprorët, sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara;
- Respektojnë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje” duhet të jenë mbi **16 vjeç** dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “ Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje”

141 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e ndihmës në punime gipsi, patinimi dhe lyerje	MK-02-392-25	10 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e e punonjësit ndihmës në gips, patinim dhe lyerje. 2. Kursanti përshkruan llojet e materialeve për punime gipsi, patinimi dhe lyerje. 3. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
2	Proçeset parapërgatitore në punime gipsi, patinimi dhe lyerje	MK-02-393-25	20 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore në punime gipsi. 2. Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore në patinim e lyerje 3. Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore në punimet veshëse të elementëve strukturor.
3	Punime ndihmëse në montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit.	MK-02-394-25	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punimeve për montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit. 2. Kursanti ndihmon në montimin e profileve metalike të strukturës. 3. Kursanti ndihmon në montimin e paneleve të gipsit .
4	Punime ndihmëse dekorative prej gipsi	MK-02-395-25	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës për punime dekorative gipsi. 2. Kursanti ndihmon në punime elementesh dekorativ me gips. 3. Kursanti ndihmon në montimin e elementeve dekorativ prej gipsi

5	Punime ndihmëse patinimi dhe lyerje	MK-02-396-25	31 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndihmon në organizimin e punës patinimit dhe lyerjes. 2. Kursanti ndihmon në punime patinimi. 3. Kursanti ndihmon në punime lyerje.
---	--	--------------	--	---

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Punime ndihmëse gipsi, patinime dhe lyerje”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lyerje”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E NDIHMËSIT NË PUNIME GIPSI, PATINIMI DHE LYERJE	MK-02-392-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët me përshkrimin e veçorive të profesionit të ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lyerje, të listojë llojet e ndryshme të materialeve, si dhe me përshkrimin e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	10 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lyerje. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: -të përshkruajë detyrat, qëndrimet kryesore të punonjësit ndihmës në punime gipsi, patinimi dhe lyerje; -të përshkruajë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike; -të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes, pastrimit, sistemimit të veglave dhe vendit të punës; -të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; -të raportojë rregullisht tek eprori për detyrën e dhënë; -të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RN2 Kursanti liston llojet e materialeve për punime gipsi, patinimi dhe lyerje.	

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë llojet e materialeve për punime gipsi;
- të listojë llojet e elementeve dekorative kornizat perimetralë, kapitele kollonash, rozetave së tavanit, harqe muresh etj.
- të listojë llojet e pllakave të gipsit sipas formës dhe përmasave;
- të listojë llojet e materialeve për punime patinimi;
- të listojë llojet e materialeve për punime lysterje;
- të dallojë llojet e pigmenteve sipas katalogut;
- të listojë llojet e profileve metalike të elementeve strukturorë;
- të listojë llojet e kallëpeve për punime dekorative;
- të listojë llojet e aksesorëve të elementeve strukturorë;
- të listojë llojet e materialet izoluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.**Kriteret e vlerësimit:**

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë pajisjet mbrojtëse (PMI) në vendin e punës;
- të përshkruajë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullores së brendshme, si dhe sinjalistikën e kantierit të ndërtimit;
- të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të përshkruajë procedurën e evakuimit në raste emergjente;
- të përshkruajë rregullat përkatëse, gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- të sigurohet me mjetet e nevojshme për punimet në lartësi;
- të identifikojë ndarjen e mbetjeve, sipas llojit.
- të shpjegojë mënyrën e transportimit të mbeturinave sipas llojit të ndarjes në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime ndërtimi në punime gipsi, patinimi dhe lysterje.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.

-
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lyerje, të listojnë llojet e tyre, si dhe përshkruajnë rregullat të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes të njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si: përshkrimin e veçorive në profesionin ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lyerje, të listojnë llojet e ndryshme të materialeve, si dhe me përshkrimin e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime gipsi, patinimi dhe lyerje,.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Proçeset parapërgatitore ndihmëse në gips, patinim dhe lyerje”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROÇESET PARAPËRGATITORE NDIHMËSE NË GIPS, PATINIM DHE LYERJE	MK-02-393-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në proçeset parapërgatitore për punimet e gipsit, patinimit dhe lyerjes si dhe me proçeset parapërgatitore ndihmëse	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime gipsi patinimi dhe lyerje”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore për punimet e gipsit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të ndihmojë në grupimin e elementeve të gipsit, sipas formës dhe dimensioneve të tyre; - të ndihmojë në përzgjedhjen të elementeve dekorativë, sipas udhëzimeve; - të ndihmojë në përzgjedhjen drejt pllakave të gipsit sipas formës dhe përmasave; - të ndihmojnë në matje dhe shënime të sakta në pllakat e gipsit sipas skicës; - të ndihmojë në prerjen me makineri të gipsit sipas përmasave në skicë; - të ndihmojë në përgatitjen e kallëpit / shabllonit për elemente dekorativë; - të ndihmon në përforcimet e kallëpeve/ shablloneve; - të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim.	

RN 2 Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore për punimet e patinimit e lyerjes.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë vetitë kryesore të materialeve të patinimit dhe lyerjes sipas paketimit përkatës;
- të ndihmojë në përzgjedhjen e llojeve të materialeve patinuese sipas përdorimit;
- të ndihmojë në përzgjedhjen e llojeve të materialeve lidhëse sipas përdorimit;
- të ndihmojë në përzgjedhjen drejt të bojrave për lyerje sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në përzgjedhjen drejt të pigmentet sipas udhëzimeve të katalogëve;
- të kryejë mirëmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RN 3 Kursanti ndihmon në proçeset parapërgatitore në punimet veshëse të elementëve strukturorë .

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në përzgjedhjen drejt e materialet izoluese sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në përpunimin e materialeve izoluese sipas përdorimit
- të ndihmojë në parapërgatitjen të profilave metalike të elementeve strukturorë;
- të ndihmojë në përzgjedhjen të aksesorëve të elementeve strukturorë sipas llojit të punimeve;
- të ndihmojë në matje dhe shënime të sakta në sipërfaqet që do punohet;
- të ndihmojë parapërgatitjen e materialeve veshëse të elementëve strukturorë ;
- të kryejë mirëmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime gipsi, patinimi dhe lyerje.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra të ndihmojnë kryerjen e proceseve parapërgatitore për punimet e gipsit, patinimit dhe lyerjes si dhe të ndihmojnë në kryerjen e proceseve parapërgatitore në punimet veshëse të elementëve strukturorë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si : të ndihmojnë në proceset parapërgatitore për punimet e gipsit, patinimit dhe lyerjes si dhe ndihmojnë në proceset parapërgatitore në punimet veshëse të elementëve strukturorë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime gipsi, patinimi dhe lyerje.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Punime ndihmëse në montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE NË MONTIMIN E ELEMENTEVE STRUKTUROR DHE PLLAKAT E GIPSIT.	MK-02-394-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson kursantët me njohuritë dhe shkathtësitë praktike të nevojshme për montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime gipsi, patinimi dhe lysterje”.	
Rezultatet e të nxënies (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punimeve për montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë mënyrën e organizimit të punimeve për montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit; – të interpretojë drejt vizatimin e sistemeve të mureve të thata; – të shpjegojë rolin bazë të secilit element strukturor; – të përdorë materiale dhe mjete të thjeshta sipas udhëzimit; – të përcaktojë rradhën e punës për detyrën e dhënë; – të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; – të ndihmojë në përzgjedhjen e instrumentave matës dhe kontrollues; – të ndihmojë në përzgjedhjen e profilave metalikë, pllakave të gipsit dhe materialeve ndihmëse; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave të punës dhe mjeteve të nevojshme ;	

- të transportojë dhe shpërndajë materialet e gipsit, sipas grafikut të punimeve
- të parapërgatisë sipërfaqen që do kryhen punime për montimin e elementeve strukturor dhe pllakat e gipsit;
- të pastrojë vendin e punës para dhe pas mbarimit të punimeve;
- të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë.
- të organizojë dhe të përgatisë vendin e punës për realizimin e montimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti ndihmon në montimin e profileve metalike të strukturës .

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën e vizatimit të strukturës së sistemeve të thata;
- të ndihmojë në përzgjedhjen e drejt të profileve metalike për ndërtimin e strukturave;
- të ndihmojë në përzgjedhjen e drejt të mënyrës së duhur të përforcimit që të sigurohet qëndrueshmëria e strukturës;
- të ndihmojë në shënimin, shpimin e materialeve dhe strukturave mbajtëse;
- të ndihmojë në zbatimin e teknikave të duhura për punimin e materialit me anë të përkuljes me vegla dore;
- të ndihmojë në zbatimin e teknikave të duhura për punimin e materialit me anë të shtypjes me vegla dore;
- të ndihmojë në zbatimin e teknikave të duhura për punimin e profileve prej fletësh metalike me anë të kthimit, palosjes dhe lidhjes së fletëve;
- të ndihmojë në vendosjen e profileve të strukturës sipas radhës së punës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të krijimit të strukturës metalike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në montimin e paneleve të gipsit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë skemën e montimit të veshjes;
- të përgatisë mjetet dhe materialet e nevojshme për montimin e paneleve të gipsit ;

- të ndihmojë në përgatitjen e materialeve
- të ndihmojë në realizimin e matjeve dhe shënimeve të sakta gjatë punimit të vendosjes së materialeve termoizoluese për përmirësimin e vetive akustike;
- të ndihmojë në mbërthimin e pllakave të gipsit me respektimin e radhës së punës;
- të ndihmojë në vendosjen e rrjetave në pikat e bashkimit të pllakave të gipsit sipas fletës së detajeve në projekt;
- të ndihmojë në kryerjen e stukimeve në pikat e bashkimit të pllakave të gipsit sipas standartit;
- të respektojë rregullin dhe pastërtinë në vendin e punës gjatë dhe pas montimit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë,

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen punime në montimin e elementeve strukturor dhe pllakave të gipsit në ndërtesa. Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të montimit të elementëve strukturor dhe pllakave.

- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për montimin e elementeve strukturor dhe pllakave të gipsit në ndërtesa.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisë të praktikës së montimit të elementeve strukturor dhe pllakave të gipsit në ndërtesa.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për veshjeve të elementëve strukturor në ndërtesa me sisteme të thata.
 - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punime ndihmëse dekorative prej gipsi”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE DEKORATIVE PREJ GIPSI	MK-02-395-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët të ndihmojnë në organizimin e punës, në përgatitjen e elementeve dekorativë prej gipsi si dhe të ndihmojnë në montimin e elementeve dekorativë prej gipsi.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulin e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime gipsi patinimi dhe lyerje”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës në punime dekorative prej gipsi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – marrë detyrën e dhënë nga eprori; – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të rendisë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për punime dekorative prej gipsi; – të kontrollojë veglat e punës dhe mjetet e nevojshme para përdorimit të tyre; – të ndihmojë në kontrollin paraprak të sipërfaqeve për punime dekorative prej gipsi; – të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së elementeve të skelës me konstruksionin e ndërtesës; – të koordinojë punën me kolegët/ specialistë e tjerë; – të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe	

materialeve të punës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti ndihmon në punime elementesh dekorativ me gips.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të lexojë skica, detaje dhe simboleve të thjeshta me fragmente punimesh elementeve dekorativë;
- të ndihmojë në përzierjen me ujë të materialit puhur prej gipsi sipas udhëzimeve në paketim;
- të përziejë vajin e gatshëm në formën e njëtrajtëshme;
- të lyejë me furçë kallëpet/ shabllonet me vaj;
- të ndihmojë në mbushjen pak nga pak kallëpet/ shabllonet me materialin e përgatitur duke zbatuar afatin kohor;
- të ndihmojë në rrafshimin e materialit duke hequr tepërit;
- të kryejë procesin e tharjes së materialit në kallëp duke zbatuar afatin kohor;
- të ndihmojë në nxjerjen e elementit nga kallëpi në mënyrë të ngadaltë;
- të ndihmojë në kryerjen e stukimeve në vendet ku ka defekte të elementit;
- të ambalazhojë dhe magazinojë produktet e gatshme të elementeve dekorativë;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndihmon në montimin e elementeve dekorativë prej gipsi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndihmojë në përgatitjen e materialit ngjitës sipas udhëzimeve në paketim;
- të ndihmojë në përpunimin e elementëve të gatshëm dekorativë sipas skicës
- të lyejë bazën e elementeve të gatshme dekorative me materialin ngjitës;
- të ndihmojë në ngjitjen e elementëve të gatshëm dekorativë duke i përpunuar ato me sipërfaqet përkatëse;
- të ndihmojë në kontrollin me mjete matëse niveluese për detyrën e kryer;
- të kryejë mirëmbajtja e punimeve sipas udhëzimeve;
- të përgatisë bojakun për lidhje elementesh sipas udhëzimeve;

- të kryejë lidhjen me bojak midis elementeve sipas udhëzimeve;
- të kryejë pastrimin e sipërfaqes së punuar.
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime gipsi, patinimi dhe lyerje

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra të ndihmojnë në: organizimin e vendit të punës, në përgatitjen e elementeve dekorativë prej gipsi si dhe të ndihmojnë në montimin e elementeve dekorativë prej gipsi.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si : të ndihmojnë të organizojnë vendin e punës, të ndihmojnë të përgatitnin elementët dekorativë prej gipsi si dhe të ndihmojnë të montojnë elementet dekorativë prej gipsi.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënërit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime gipsi, patinimi dhe lyerje.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Punime ndihmëse patinimi dhe lyerje”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE PATINIMI DHE LYERJE	MK-02-396-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët të ndihmojnë në organizimin e punës, ndihmojnë në punime patinimit dhe lyerjes	
Kohëzgjatja e modulit	31 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën e parë “Hyrje në profesionin e ndihmësit në punime gipsi patinimi dhe lyerje”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti ndihmon në organizimin e punës Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të shpërndajë bazën materiale, sipas udhëzimeve përkatëse; – të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit në grup me kolegë/specialistë të tjerë; – të rendisë radhën e punës për detyrën e dhënë, duke u konsultuar me specialistin; – të ndihmojë në përzgjedhjen e veglave e mjeteteve të nevojshme për punime ndihmëse patinimi dhe lyerje; – të kontrollojë veglat e punës dhe mjetet e nevojshme para përdorimit të tyre; – të ndihmojë në identifikimin e lidhjes së elementeve të skelës me konstruksionin e ndërtesës; – të koordinojë punën me kolegë duke raportuar tek eprori sipas hierarkisë; – të pastrojë vendin e punës para punimeve; – të sigurojë ndriçimin e duhur; – të kryejë mirmbajtjen, sistemimin e veglave dhe materialeve të punës; – të përdorë informacionet mbi zhvillimet e teknologjisë. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgimi me listë kontrolli	

RN 2 Kursanti ndihmon në punime patinimi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë skica, detaje dhe simboleve të thjeshta me fragmente punimesh patinimi;
- të ndihmojë në zmerilimin e sipërfaqeve me materialin e duhur;
- të pastrojë sipërfaqen e punuar sipas udhëzimeve;
- të përgatitë stukon për patinim në raportin e duhur me ujë sipas recepturave të paracaktuara dhe udhëzimeve;
- të ndihmojë në kryejen e patinime në varësi të sipërfaqes;
- të ndihmojë në kryejen e smerilimit të sipërfaqes së patinuar me mjete përkatëse;
- të pastrojë sipërfaqen e patinuar sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në lyerjen e sipërfaqes me astar;
- të ndihmojë në kontrollin përfundimtar të sipërfaqeve të patinuara;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli

RN 3 Kursanti ndihmon në punime lyerje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të lexojë skica, detaje dhe katalogje të thjeshta me fragmente lyerje;
- të vendosë materiale mbrojtëse në sipërfaqet që nuk do të lyhen që mos të dëmtohen;
- të pastrojë sipërfaqen për bojatisje me materialet dhe solucionet përkatëse;
- të ndihmojë në përzjerjen e bojës me pigmentin përkatës sipas katalogut duke e provuar në një sipërfaqe muri;
- të ndihmojë në ndarjet e nevojshme të sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme sipas skicës
- të ndihmojë në lyejë me astar të gatshëm sipërfaqen që do të lyhet sipas udhëzimeve;
- të ndihmojë në bojatisjen e dorës së parë sipas llojit të sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme;
- të ndihmojë në bojatisjen e dorës së dytë sipas llojit të sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme;
- të sistemojë, pastrojë vendin dhe veglat e punës mbas mbarimit të detyrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e ruajtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

- Vëzhgimi me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime patinimi dhe lyerje. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. – Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t`u jepen detyra të ndihmojnë në organizimin e vendit të punës dhe të ndihmojnë në patinime dhe lyerje. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul si : të ndihmojnë të organizojnë vendin e punës, të ndihmojnë të patinojnë dh lyejnë - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime patinimi dhe lyerje. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.